



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PRIZREN

Numri i lëndës: 2019:087420 C. nr. 179/2016  
Datë: 01.02.2024  
Numri i dokumentit: 05273576

GJYKATA THEMELORE NË PRIZREN - Departamenti i Përgjithshëm, gjyqtari Atdhe Berisha, me bashkëpunëtorin profesional I.S. në çështjen juridike kontestimore të paditëses Kompania Kosovare për Distribuim dhe Furnizim me Energji Elektrike, Sh.A (KEDS), me seli në Prishtinë, të cilën me autorizim e përfaqëson G.H. zyrtare Ligjore pranë paditëses, kundër të paditurit T.B.Q. nga fshati ..... Komuna e Prizrenit, të cilin me autorizim e përfaqëson D.N. avokat nga Prizreni, për shkak të kompensimit të dëmit material, vlera e kontestit 2,311.28 euro, pas mbajtjes së shqyrtimit kryesor publik, me datën 16 Janar 2024, mori këtë:

A K T G J Y K I M

I. Miratohet kërkesëpadia e paditëses Kompania Kosovare për Distribuim dhe Furnizim me Energji Elektrike Sh.A (KEDS), me seli në Prishtinë, detyrohet i padituri T.B.Q. nga fshati ..... Komuna e Prizrenit, që në emër të kompensimit të dëmit material për shkak të shfrytëzimit të paautorizuar të energjisë elektrike, t'ia kompensoi paditëses shumën prej 2,311.28 € ( dymijë e treqind e njëmbëdhjetë euro e njëzet e tetë cent) me kamat ligjore 8% në vit, duke llogaritur nga data e dorëzimit të padisë (21.12.2015), e deri më pagesën definitive, të gjitha këto brenda afatit 15 ditor pas ditës së pranimit të këtij aktgjykimi, nën kërcënim të përbarimit me dhunë.

II. Obligohet i padituri, që t'ia paguajë paditëses shpenzimet procedurale sa i përketë taksës gjyqësore dhe atë në shumën prej 20 € (njëzetë euro) në afatin prej 15 ditësh pas ditës së pranimit të këtij aktgjykimi, nën kërcënim të përbarimit me dhunë.

A r s y e t i m

Paditësja Kompania Kosovare për Distribuim dhe Furnizim me Energji Elektrike, Sh.A (KEDS), me seli në Prishtinë, pranë kësaj gjykate ka parashtuar, padi kundër të paditurit T.B.Q. nga fshati .... Komuna e Prizrenit, për shkak të kompensimit të dëmit, duke thekuar se prej datës së pa vërtetuar e deri më datë 01.12.2013, me qëllim që t'i sjellë vetit pasuri të kundërligjshme e ka shfrytëzuar energjinë elektrike në mënyrë të pa autorizua, duke e keqpërdorur njehsorin elektrik ashtu që ka manipuluar duke e shfrytëzuar energjinë elektrike në mënyrë të pa autorizuar ku energjia e shpenzuar nuk është regjistruar, duke i shkaktuar dëm paditëses në vlerë prej 2,311.28 euro. Sipas aktgjykimit të plotfuqishëm të Gjykatës Themelore në Prizren, P.nr.1369/2014 të datës 26.06.2015, i cili është bërë i plotfuqishëm me datë 28.08.2015, këtu i padituri është shpallur fajtor për veprën penale të vjedhjes së shërbimeve komunale nga nenin 320 par.1 i KP-së, ndërsa që paditësja për realizimin e kërkesës pasurore juridike, është udhëzuar në kontest civil. Meqenëse i padituri, deri më tani nuk ka bërë pagesën e dëmit të shkaktuar, paditësja në padi i ka propozuar gjykatës të caktoj shqyrtimin kryesor, t'i nxjerr provat e nevojshme dhe pas vlerësimit të tyre të bjerë aktgjykim, duke e aprovuar padinë dhe kërkesëpadinë e paditëses, duke e obliguar të paditurin që paditëses t'ia paguajë dëmin material të shkaktuar dhe atë në vlerë prej 2,311.28 euro, dhe atë me kamatë ligjore nga dita e

ushtrimit të padisë e gjer në pagesën definitive duke përfshirë edhe shpenzimet e procedurës të gjitha këto në afat prej 15 ditësh me kërcënim të përmbarimit të dhunshëm.

Edhe përgjatë shqyrtimit gjyqësor, e autorizuar e paditëses G.H. ka deklaruar se mbetet në tërësi pranë padisë dhe kërkesëpadisë si dhe deklarimeve nga seancat e kaluara, ndërkaq në fjalën përfundimtare ka theksuar faktin se këtu i padituri është shpallur fajtor për veprën penale vjedhja e shërbimeve komunale e për të cilën e ka pranuar fajësinë dhe atë sipas aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Prizren, me numër P.nr.1369/2014 të datës 26.06.2015. Pas administrimit të provave është vërtetuar fakti se i padituri i ka shkaktuar dëm KEC-it, në lartësinë si në padi pasi që pas shikimit të procesverbalit nga qendra e kalibrimit është konstatuar që ka pasur manipulim në njehsorin elektrik përmes një shiriti filmik i cili është vërtetuar përmes fotove të administruara. Sipas procesverbalit me numër 0814625 i datës 17.01.2014, tek i padituri janë marrë fuqitë e pajisjeve elektrike të cilat i ka pasur në shfrytëzim në shtëpinë e tij dhe sipas fuqisë së tyre është bërë kalkulimi i rikthimit të humbjeve të evidentuara si në faturën me nr. DPZ14KP07869 të datës 29.04.2014, ku është shënuar edhe lartësia e dëmit në shumë prej 2,311.28 euro, vlerë kjo e kalkuluar konform rregullores për identifikim dhe parandalim shfrytëzimit të energjisë elektrike. Andaj, i ka propozuar gjykatës që ta aprovoj në tërësi padinë dhe kërkesëpadinë e paditëses duke i kërkuar edhe shpenzimet e procedurës sa i përket taksës gjyqësore në vlerë prej 20 euro.

I autorizuari i paditurit T.Q. avokat D.N. nga Prizreni, ka dhënë përgjigjen në padi me shkrim më datë 28.12.2018, ka theksuar se padia është e parregullt ngase ekziston mospërputhja e kërkesës së parashtruar dhe vlerës së thekuar. Pasi që padia bazohet në një aktgjykim të plotfuqishëm penal nga e cila paraqitet si e dëmtuar dhe me një dëm të shkaktuar, e cila pretendon të vërtetohet nga ekspertiza e vet paditëses njëanshmërisht. Meqenëse pretendimi i dëmit rrjedh nga furnizimi i energjisë elektrike, nga e cila kërkohet për periudhën deri në vitin 2013, meqenëse padia e parashtruar është e datës 21.12.2015, e njëjta është e përfshirë në parashkrim, andaj në këtë kontest i propozoj gjykatës që padinë dhe kërkesëpadinë ta refuzoj si të pabazuar.

Ndërsa në fjalën përfundimtare i autorizuari i të paditurit av. D.N. ka theksuar se përfaqësuesi i paditëses në as një fazë nuk ka pretenduar që nga provat e parashtruara të vërtetohet një fakt e më pastaj të propozohet një kundër provë, ngase provat e parashtruara nuk janë prova bindëse për tu vërtetuar kërkesëpadia. Sa i përket provës së administruar aktgjykimin penal, konsideroj që e njëjta është nxjerrë në kundërshtim me dispozitat e procedurës penale ngase këtu i padituri nuk është njoftuar për të drejtat apo për pasojat e pranimit të fajësisë. Nga prova materiale e administruar fatura e datës 29.04.2014, e ka kundërshtuar për faktin se e njëjta nuk është provë bindëse lidhur me lartësinë e dëmit të pësuar nga veprimet e paditurit, pasi që të njëjtat nuk janë të besueshme për ta bërë këtë llogaritje pasi që janë të njëanshme. Lidhur me procesverbalin e datës 17.01.2014, e njëjta është përpiluar nga pala paditëse, gjatë konstatimit të aparateve shpenzues në shtëpinë e të paditurit ka qenë një person prezent i cili nuk di shkrim dhe lexim, duke vazhduar më tej se ky procesverbal mban ndërhyrje të personave të pa autorizuar për shkak se ekziston edhe një i datës 25.04.2014, për të cilën paraqitet një dyshim tjetër për anshmëri. Duke shtuar se procesverbali i datës 09.12.2013, përmban konstatime të njëanshme lidhur me një njehsor që për të paditurin është i panjohur ngase asnjë nga fotografitë e administruara nuk e vërteton që ky njehsor qenka nxjerrë nga shtëpia e të paditurit, ngase këto fotografi nuk është kontestuese që përmbajnë një njehsor i cili njehsor mund të jetë edhe i dikujt tjetër, andaj mbi bazën e deklarimeve konsideroj që lartësia e kërkesëpadisë nuk është provuar në mënyrë të drejtë dhe të pa anshme nga ana e palës paditëse për faktin se nuk është bërë asnjë ekspertizë nga lëmia e elektros e cila mbase do të ishte bazë më bindëse për lartësinë e kërkesëpadisë. Andaj, i ka propozuar gjykatës që kërkesëpadia e paditëses të refuzohet si e pa

bazuar dhe gjykata të mos ja falë besimin dhe ta obligon palën e paditur kompensimin e dëmit me provat e një anshme. Shpenzimet e procedurës i ka kërkuar dhe atë për përpilimin e përgjigjes në padi në shumë prej 104 euro, dhe për dy seanca të mbajtura në shumën prej 135.20 euro në shumën e përgjithshme prej 374.4 euro.

Gjykata më qëllim të konstatimit dhe vërtetimit të plotë dhe të drejt të gjendjes faktike ka administruar këto prova: aktgjykimin e plotfuqishëm të Gjykatës Themelore në Prizren, P.nr.1369/2014 të datës 26.06.2015, i cili është bërë i plotfuqishëm me datë 28.08.2015, ka bërë shikimin e faturës së kthimit të humbjeve më nr. DPZ14HP07869 i datës 29.04.2014, është bërë shikimi i procesverbalit me nr. 0814625 i datës 17.01.2014, ka bërë shikimin e procesverbalit nga sektori i qendrës së kalibrimit me nr.1.URG 02.nr.21515 e datës 09.12.2013, si dhe është bërë shikimi i foto dokumentacionit prej 7 fotosh.

Me vlerësimin e gjithanshëm të të gjitha provave të administruara, fakteve të vërtetuara, veçmas secilën si dhe në kuptim të nenit 8 të Ligjit Për Procedurën Kontestimore (LPK), me kujdes dhe me ndërgjegje ka çmuar çdo provë veç e veç dhe të gjitha atë së bashku dhe ka gjetur se:

Kërkesëpadia e paditëses është e bazuar.

Në bazë të aktgjykimit penal të Gjykatës Themelore në Prizren, P.nr.1369/2014 të datës 26.06.2015, i cili është bërë i plotfuqishëm me datë 28.08.2015, gjykata e ka provuar faktin se këtu i padituri T.B.Q. nga fshati ... Komuna e Prizrenit, është shpallur fajtorë pasi që ka kryer veprë penale të vjedhjes së shërbimeve komunale nga neni 320 të KPK-së, me ç'rast paditëses i ka shkaktuar dëm material në shumën prej 2,311.28 €, më gjerësisht sikurse në këtë aktgjykim.

Nga shikimi në faturën e rikthimit të humbjeve me numër DPZ14HP07869 i datës 29.04.2014, gjykata ka vërtetuar se lartësia e dëmit të shkaktuar nga i padituri është 2,311,28 euro, vlerë kjo e kalkuluar konform rregullores për identifikim dhe para ndalim të shfrytëzimit të pa autorizuar të energjisë elektrike.

Nga leximi i procesverbalit me numër 0814625 të datës 17.01.2014, i hartuar nga KEDS-i, gjykata ka vërtetuar faktin se nga zyrtarët e KEDS-it, në shtëpinë e të paditurit ka marrë fuqinë e pajisjeve elektrike të cilat i ka pasur në shfrytëzim në shtëpinë e tij për të cilat pajisje sipas fuqisë së tyre është bërë kalkulimi i humbjeve të evidentuara si në faturën e datës 29.04.2014.

Nga leximi i procesverbalit me numër 21515 të datës 09.12.2013, i hartuar nga KEDS-i, gjykata ka vërtetuar faktin se nga kontrolli detal i njehsorit të energjisë elektrike është konstatuar se njehsori elektrik pllombat shtetërore i ka në rregull, por për rreth qelqit nga ana e majtë është futur shiriti filmik dhe është prerë kufizuesi i qelqit, në këtë mënyrë është penguar puna e diskut, ku në brendi të njehsorit ka pasur pluhur të shiritit filmik.

Nga shikimi i foto dokumentacionin gjykata ka vërtetuar faktin se njehsori me numër 1523450, ka qenë në shtëpinë e të paditurit, dhe pas kalibrimit të të njëjtit njehsor, shifet se si është penguar puna e diskut ku në brendësi të njehsorit ka pasur pluhur të shiritit filmik.

Gjykata vendosi si në dispozitivin I (një) të këtij aktgjykimi, në aplikim të nenit 136 të LMD-së, thotë: *“ Kush i shkakton tjetrit dëm ka për detyrë ta kompensojë, përveç nëse vërtetohet se dëmi është shkaktuar pa fajin e tij”*. Neni 169 i LMD-së, thotë: *“Personi përgjegjës ka për detyrë ta rivendosë gjendjen e cila ka qenë para se të shkaktohet dëmi. Në qoftë se rivendosja e gjendjes së mëparshme nuk e mënjanon plotësisht dëmin, personi përgjegjës ka për detyrë që*

*për pjesën tjetër të dëmit të japë shpërblimin në të holla*". Sipas nenit 14 të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK), është paraparë se *"Në procedurën kontestimore gjykata më pikëpamje të ekzistimit të veprës penale dhe të përgjegjësisë penale të kryerësit, është e lidhur me aktgjykimin e formës së prerë të gjykatës penale, me të cilin i pandehuri është shpallur fajtor"*. Po ashtu me nenin 7.1 të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK) është paraparë se *"Palët kanë për detyrë që të paraqesin të gjitha faktet mbi të cilat i mbështesin kërkesat e veta dhe të propozojnë prova me të cilat konstatohen faktet e tilla"*. Gjykata përmes provave të administruara të cilat dërguan në gjendjen faktike të vërtetuar, gjeti se i padituri duhet të mbahen përgjegjëse për shkaktimin e dëmit material në këtë rast kontestues. Kjo ngase i paditurit duke manipuluar me njehsorin elektrik përmes një shiriti filmik i cili është vërtetuar përmes aktgjykimit penal P.nr.1369/2014 i datës 26.06.2015, dhe nga procesverbali i kalibrimit të datës 09.12.2013, duke i shkaktuar dëm material paditëses në shumë prej 2,311.28 euro vlerë kjo e kalkuluar konform rregullores për identifikim dhe parandalim të shfrytëzimit të pa autorizuar të energjisë elektrike.

Në bazë të gjendjes faktike të vërtetuar në këtë procedurë është provuar se i padituri T.Q. nga fshati ..... Komuna e Prizrenit, i ka shkaktuar dëm material këtu paditëses Kompanisë Kosovare për Distribuim dhe Furnizim me Energji Elektrike, Sh.A (KEDS), seli në Prishtinë, përmes shfrytëzimit të paautorizuar të energjisë elektrike, pasi që është vërtetuar se njehsori elektrik i të paditurit, për rreth qelqit nga ana e majtë është futur shiriti filmik dhe është prerë kufizuesi i qelqit e në këtë mënyrë është penguar puna e diskut, në brendi të njehsorit ka pasur pluhur të shiritit filmik, për çka i padituri ka detyrim për kompensimin e këtij dëmi ndaj paditëses. Pasi që paditësja i ka ofruar gjykatës si provë aktgjykimin e plotfuqishëm të Gjykatës Themelore në Prizren P.nr.1369/2014 të datës 26.06.2014, i cili është bërë i plotfuqishëm me datë 28.08.2015, përmes të cilit vërtetohet fakti se këtu i padituri e ka pranuar fajësinë dhe është shpallur fajtorë për veprën penale të vjedhjes së shërbimeve komunale nga neni 320 të KPK-së, me ç' rast edhe është konstatuar shuma e dëmit të shkaktuar. Po ashtu paditësja si provë gjykatës i'a ka parashtruar edhe faturën mbi shpenzimin e paautorizuar të energjisë elektrike me nr. DPZ14HP07869 i datës 29.04.2014, e cila është hartuar konform rregullores për identifikim dhe parandalim të shfrytëzimit të pa autorizuar të energjisë elektrike, si dhe procesverbalin e kontrollit detal të njehsorit të energjisë elektrike me numër 21515 të datës 09.12.2013, gjykata vërtetoj se njehsori për rreth qelqit nga ana e majtë është futur shiriti filmik dhe është prerë kufizuesi i qelqit duke e penguar kështu punën e diskut dhe brenda njehsorit ka pasur pluhur të shiritit filmik, të cilave prova gjykata i'a fali besimin e plotë, e përmes të cilave është vërtetuar edhe lartësia e shumës së shpenzuar e energjisë elektrike në mënyrë të kundërligjshme nga ana e të paditurit, respektivisht lartësia e dëmit që i është shkaktuar këtu paditëses nga ana e të paditurit.

Sa i përket pretendimeve të përfaqësuesit të paditurit lidhur me çështjen e lartësisë së dëmit për faktin se llogaritja e dëmit është bërë njëanshëm nga ana e palës paditëse si në procedurën penale aso kohe edhe në procedurë kontestimore, duke konsideruar që për matjet e humbjeve nga ana e njehsorit organi kompetent është instituti metrologjis për të cilën në shkresat e lëndës nuk gjendet as një konstatim i këtij institucioni, e po ashtu as ndonjë ekspertizë e pavarur nga lëmia e elektros, andaj mbi bazën e mungesës së provave ka kërkuar që kërkesëpadia të refuzohet si e pa bazuar. Gjykata, të njëjtat pretendime i konsideroj si të pa bazuara, për faktin se bazuar në procesverbalin me numër 0814625 i datës 17.01.2014, zyrtarët e KEDC-it, kanë qenë në teren në bazë të procesverbalit të kalibrimit tek i padituri janë marrë fuqitë e pajisjeve elektrike të cilat i ka pasur në shfrytëzim në shtëpinë e tij ku në këtë procesverbal është edhe nënshkrimi i vet të paditurit dhe në bazë të këtyre pajisjeve është bërë edhe kalkulimi i rikthimit të humbjeve të evidentuara si në faturën me numër DPZ14KP07869 e datës 29.04.2014, ku është shënuar edhe lartësia e dëmit në shumë prej 2,311.28 euro, vlerë kjo

e kalkuluar konform rregullores për identifikim dhe parandalim të shfrytëzimit të pa autorizuar të energjisë elektrike. Lidhur me pretendimet e të autorizuarit të paditurit se nuk ka pasur ndonjë ekspertizë nga lëmia e elektros, të njëjtat pretendime gjykata i konsideroj si të pa bazuar për faktin se në procesverbalin e seancës përgatitore të datës 14.12.2023, gjykata ka kërkuar nga palët që të sqarohen lidhur me propozimet për prova të cilat do të mund të administroheshin në shqyrtim kryesor, pasi që palët kanë për detyrë t'i paraqesin të gjitha faktet mbi të cilat i mbështesin kërkesat e veta dhe të propozojnë prova me të cilat konstatohen faktet e tilla, të cilën nuk e kanë shfrytëzuar as i padituri e as mbrojtësi i tij.

Gjykata vendosi sikurse në dispozitiv të këtij aktgjykimi duke aprovuar shumën përkatëse dhe duke llogaritur kamatën ligjore prej 8 % bazuar në nenin 382 par. 1 dhe 2 të LMD-së, e cila fillon të rrjedh nga data e paraqitjes së padisë në gjykatë (21.12.2015).

Vendimi mbi shpenzimet procedurale është nxjerr konform nenit 452 të LPK-së dhe atë vetëm për shpenzimet në emër të taksës gjyqësore në shumën prej 20 euro, siç edhe janë kërkuar nga ana e vet paditëses.

Nga të dhënat e cekura më lartë gjykata vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, bazuar në dispozitat ligjore të cekura në arsyetimin e këtij aktgjykimi, lidhur me nenin 143 të LPK-së.

GJYKATA THEMELORE NË PRIZREN  
C. nr. 179/2016, datë 16 Janar 2024

Gjykatësi  
Atdhe Berisha

**UDHËZIM JURIDIK:** Kundër këtij aktgjykimi pala e pakënaqur, ka të drejtë ankese në afat prej 15 dite pas pranimit të të njëjtit, Gjykatës së Apelit në Prishtinë, e nëpërmjet kësaj Gjykate.